

Hapet thirrja për aplikime për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të Konsorciumit UNIADRION, i financuar nga Programi Erasmus +, në Universitetin e Udine, Itali, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

Në kuadër të programit Erasmus+ është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mësimdhënie për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Udine, Itali, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

https://www.uniud.it/en/uniud-international?set_language=en

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;

Fushat e shkëmbimit:

- Drejtësi;

<https://www.uniud.it/en/education/information/contacts-details#autotoc-item-undefined-6>

Kohëzgjatja:

- 5 +2 ditë;

Bursat përfshijnë:

-Kompensim (160 Euro/dita);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë:

- CV (në gjuhën angleze / italiane);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze / italiane);
- Vërtetim punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;

- Vërtetim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, duhet të specifikoni mobilitetet e kryera duke cituar universitetet pritëse dhe periudhën e secilit prej tyre);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënie. Ky dokument firmoset nga aplikanti në momentin e aplikimit dhe më pas nga Koordinatori Institucional Erasmus+.

Afati për aplikim: **17 Mars 2023**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!